



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS – SHTIME
Komiteti për Komunitete
Nr.01-060/01-30633/24 datë:25.11.2024



Npi – 01/378 datë: 27.11.2024

Duke u bazuar në nenin 49 dhe 53 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, Si dhe në bazë të nenit 3.8 dhe 3.13 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve Npi – 01/114 datë: 26.04.2019. Komiteti për Komunitete për mbledhjen e mbajtur më: 27.11.2024, nxjerr këtë:

E K S T R A K T
P R O C E S V E R B A L

I M B L E D H J E S S Ë -X I- T Ë K O M I T E T I T P Ë R K O M U N I T E T E

E mbajtur më: 27.11.2024 (e mërkurë) në ora 10:00 h. në sallën e vogël të Kuvendit.

Në mbledhje kanë marrë pjesë, Kryesuesi, z.Bajram Ilazi, anëtarët e Komitetit për Komunitete: z.Besnik Seferi, znj.Rrezartë Ramadani, z.Muhamet Mehmeti, dhe z.Arton Demiri. Në mbledhje ka munguar Shkurte Mustafa, ndërsa znj.Shkurte Behluli ka dhënë dorëheqje. Përveç anëtarëve të Komitetit në mbledhje kanë marrë pjesë edhe: Drejtori i DBF-së z.Besnik Ahmeti, Nga OSBE-ja z.Muharrem Haziri, pastaj edhe znj.Vlora Hyseni nga zyra për Informim. Mbledhjen e hapi Kryesuesi i Komitetit z.Bajram Ilazi, i cili pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, Konstatoi Kuorumin e mjaftueshëm për të vazhduar me mbledhjen Komitetit. Për këtë mbledhje kemi propozuar këtë:

R E N D D I T E

1. Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja më 30.10.2024,
2. Draft-Rregullore për Taksa, Tarifa dhe Gjoha për vitin 2025, (pas diskutimit publik)
3. Draft-Strategjia dhe Plani i Veprimit për personat me aftësi të kufizuara për periudhën 2025-28, (pas diskutimit publik)
4. Formimi Grupit Punues për hartimin e Planit të punës dhe Orarit të mbledhjeve të KPK për 2025,
5. Të ndryshme.

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi; Hapi diskutimin për rendin e ditës.

***Komiteti për Komunitete, unanimisht miratoi rendin e ditës.**

Pika 1

Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja më 30.10.2024

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

***Komiteti për Komunitete, unanimisht miratoi Ekstrakt Procesverbalin nga mbledhja më 30.10.2024.**

Pika 2

Draft-Rregullore për Taksa, Tarifa dhe Gjoha për vitin 2025, (pas diskutim publik)

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi; Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha Besnik Ahmeti.

z.Besnik Ahmeti, drejtor i DBF: Përshëndetje, Draft-rregullorja për Taksa, Tarifa dhe Gjoha për vitin 2025 ka shkuar në diskutim publik sipas vendimit të Kuvendit. Diskutimi është mbajtur dhe kemi disa propozime për ndryshimin e sajë. Te DSHP-ja janë propozuar tarifa të reja të përshkallëzuara për sa u përket kompanive që e shfrytëzojnë gurin si dhe për guroret. Pastaj te DZHE-ja lidhur me pëlqimet që janë lëshuar sipas nenit 7 të rregullores tanë kanë kaluar në nivelin qendror, dhe këto hiqen nga rregullorja. Kemi edhe propozime për disa tarifa të reja te DKRS-ja lidhur me shfrytëzimin e hallës sportive. Propozimet e reja për tarifa mund ti shikoni në draftin final të rregullores për tarifa të cilën e keni pranuar, kështu që nëse ka ndonjë pyetje do të përpiqem të përgjigjem.

z.Besnik Seferi: Po kërkoj një sçarim për te palestra e sporteve, më vjen mire që është anashkalu për aktivitetet jopolitike. Këto tarifa janë për qytetarët tjerë e jo për klubet sportive të komunës tonë.

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi; Nëse nuk ka diskutime tjera po e vej në votim, konstatoj Kuorumin prej 5 anëtarëve të Komitetit prezent në mbledhje.

*** Komiteti për Komunitete në mbledhjen e -XI- për vitin 2024, të mbajtur më: 27.11.2024, unanimisht vendosi që t'i rekomandon Kuvendit të Komunës së Shtimes që të Aprovojë Rregulloren për Taksa, Tarifa dhe Gjoha për vitin 2025.**

Pika 3

Draft-Strategjia dhe Plani i Veprimit për personat me aftësi të kufizuar për periudhën 2025-28, (pas diskutimit publik)

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Besnik Ahmeti, drejtor i DBF: Me këtë Strategji caktohen dhe parashihen kryerjen e shërbimëve më të shpejta dhe më të lehta për personat me aftësi të kufizuar. Diskutimi public është mbajtur, mirëpo nuk ka ndonjë propozim konkret. Ne pretendojmë që në vitin e parë me startuar me 40% dhe në vitin 2028 me e përmbyllë komplet Strategjinë dhe Planin e Veprimit për personat me aftësi të kufizuar. Ata persona me aftësi të kufizuar janë familjarë tanë dhe unë ju rekomandoj që ta miratoni dhe të ja përcillni Kuvendit rekomandimin.

z.Besnik Seferi: Faleminderit për informatën. Kjo është një Strategji që po bëhet për here të parë në Komunën tonë, por edhe më gjerë. Unë kam pa një përkushtim dhe kam pa diskutime të mira për këtë Strategji. Qëllimi i kësaj Strategjije është që në Komunën tonë të sigurojmë një mjedis sa më të përshtatshëm për personat me aftësi të kufizuar. Unë jam "Pro" dhe do ta përkrahu, uroj që të implementohet në tërësi kjo Strategji.

z.Besnik Ahmeti, drejtor i DBF; Ne jemi komuna e dytë pas Lipjanit që e kemi bërë një Strategji dhe Plan të tillë të veprimit.

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi; Na gëzon fakti për hartimin e kësaj Strategjije, edhe për bashkëpunimin e komunës tonë me komunat tjera dhe OJQ-të lidhur me këtë Strategji. Uroj që kjo të implementohet deri në fund. Propozoj që ta miratojmë një Rekomandim për Kuvendin. Konstatoj se në mbledhje prezent janë 5 anëtarë të Komitetit.

*** Komiteti për Komunitete në mbledhjen e -XI- për vitin 2024, të mbajtur më: 27.11.2024, unanimisht vendosi që t'i rekomandon Kuvendit të Komunës së Shtimes që të miratoi Strategjinë dhe Planin e Veprimit për personat me aftësi të kufizuar për periudhën 2025-28.**

Pika 4

Formimi Grupit Punues për hartimin e Planit të punës dhe Orarit të mbledhjeve të KPK për 2025

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi; Vitin e kaluar kanë qenë krejt anëtarët e Komitetit në Grupin punues për hartimin e Planit të Punës dhe Orarin e mbledhjeve të Komitetit. Hapi diskutimin për këtë pikë.

znj.Rrezartë Ramadani: Përshëndetje. Unë propozoj që prap me vazhdu sikurse edhe viteve të tjera që krejt anëtarët e Komitetit me qenë në grupin punues, për hartimin e Planit të Punës dhe Orarin e mbledhjeve të Komitetit.

z.Besnik Seferi: Mendoj se më e mira kishte me qenë, që të gjithë anëtarët e Komitetit me qenë në grupin punues.

z.Muhemat Mehmeti: Përshëndetje. Edhe unë i përkrahu propozimet e kolegëve, që të gjithë anëtarët e Komitetit me qenë në grupin punues.

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi; E dimë që disa aktivitete nuk kanë mund me u realizuar. Raportin do ta kemi në fund të vitit, dhe do ta shohim konkretisht se qka është realizuar e qka jo. Nëse nuk ka diskutime tjera po e vej në votim, konstatoj Kuorumin prej 5 anëtarëve të Komitetit prezent në mbledhje.

*** Komiteti për Komunitete në mbledhjen e -XI- për vitin 2024, të mbajtur më: 27.11.2024, unanimisht vendosi që për hartimin e Planit të Punës dhe Orarin e mbledhjeve të Komitetit për Komunitete për vitin 2025, të caktohen të gjithë anëtarët e Komitetit për Komunitete, si vijon: z.Bajram Ilazi, z.Besnik Seferi, znj.Shkurte Mustafa, znj.Rrezartë Ramadani, z.Muhamet Mehmeti, dhe z.Arton Demiri.**

Pika 5

Të ndryshme

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi; Para se të hapi diskutimin për këtë pikë, unë po e njpoftoj Komitetin me një rast që i është djegur shtëpia, ky është Ibrahim Haliti nga Shtimja, i cili tani ka mbetur thuaja se pa asgjë, dhe ka nevojë për shumë gjëra edhe për ato elementare siq janë ushqim veshmbathje dhe strehim. Shtëpia ishte ndërtuar para 18 viteve.

z.Besnik Seferi: Më vjen keq për këtë rast. Sigurisht që organet zyrtare siq janë Policia e Inspektorati do të punojnë që të dihet saktësisht arsyeja e këtijë zjarri. Mendoj se si rekomandim duhet ti shkojë DSHMS-së që të marrin informacione dhe të sqarohet rasti.

znj.Rrezartë Ramadani: Pajtohem me Besnikun, që ne si KPK-ë nuk kemi mundësi të sqarojmë aty diçka, dhe pajtohem për një rekomandim adresuar DSHMS-së.

z.Muhamet Mehmeti: Unë i kamë telefonuar i pari pasi ka ndodhur rasti. Unë jam munduar me i ndihmuar sa kam pas mundësi me tesha dhe me disa libra për fëmijë, sepse u janë djegur të gjitha. Kanë pasë edhe lëndime trupore. Unë paraprakisht kam diskutuar edhe me drejtoreshën e DSHMS-së, kështu që edhe unë jam i pëlqimit që ta bëjmë një rekomandim.

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi; Pajtohem mos me dalë në teren, sepse nuk mundemi me i ndihmuar diçka konkretisht, financiarisht, por edhe unë jam për një rekomandim për DSHMS-në. Gati rast të njejt me djegje të shtëpisë kemi pasur edhe para disa muajve në fshatin Gjyrkovc.

z.Besnik Seferi: Disa pjestar të Komunitetit po mendojnë se ne mund të vendosim për të gjitha gjërat. Vetëm unë i kam 4 kërkesa për ndërtim të shtëpive. Unë jamë dakord me dalë në teren por bashkë me zyrtarët përgjegjës. DSHMS-ja e ka për obligim me u marrë me një çështje të tillë.

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi; Unë po e marr obligim që ti shkruaj një e-mail Kryetarit për me dalë bashkë për vizitë të këtyre familjeve.

*** Komiteti për Komunitete në mbledhjen e -XI- për vitin 2024, të mbajtur më: 27.11.2024, unanimisht vendosi që t'i Rekomandon Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, që drejtoresha të del në vendin e ngjarjes dhe të shikon nga afër gjendjen e familjes të Ibrahim Halitit nga Shtimja, të cilit para pak ditësh ju ka shkatrruar shtëpia nga zjarri, mbase kjo familje mund të ketë nevojë edhe për gjëra elementare.**

z.Muharrem Haziri, përfaqësues nga OSBE: Përshëndetje. Sa do që po mundohem mos me folë, por prap po duhet dhe faleminderit për fjalën. Ju si Kryesues por edhe Muhameti si Zëvendës Kryesues, duhet me marrë pjesë në të gjitha mbledhjet e KKSBB-së, dhe aty me i adresuar të gjitha rastet me i diskutuar dhe me i trajtuar. Kte po e them për arsye se aty janë prezent gati të gjithë faktorët përgjegjës. Këtë problem po e kanë edhe komunat tjera jo vetëm ju, sepse nuk po i shfrytëzoni kompetencat e juaja.

z.Besnik Seferi: E para qka desha ta di është një sçarim i shkurtë për anëtarin e Komitetit Shkurte Behlulin. Dhe e dyta meqenëse jemi në prag të festave të fëdëvitit, do ishte mirë një organizim për ndarjen e disa dhuratave nëpër shkollat për fëmijët e komunitetit.

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi; Dhuratat mendoj se nuk bën me i nda për fëmijët e komuniteteve nëpër shkollat sepse mund të duket jo mirë, me bërë ndarje të fëmijëve. Unë më shumë kisha dashur që mos me u nda dhe mos me bërë dallime, fëmijët e komuniteteve pakicë nga fëmijët e komunitetit shumicë.

z.Muhamet Mehmeti: Me mujt me gjet ndonjë donator do të ishte mirë, sepse janë shumë nxënës mbi 900 nxënës që nuk bën me i nda me dhurata.

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi; Merrne përsipër ti Besnik, Muhamet dhe ti Besarta për me realizuar këtë iniciativë. Pasi që diskutime tjera nuk kishte mbledhjen Kryesuesi e përfundoi në ora 11:25h.

Procesmbajtës
Idajet Rexhepi



Kryesuesi i Komitetit
Bajram Ilazi

